

## DOKUMENTACIONI TEKNIK PËR KRYERJEN E OPONENCËS SË PROJEKTEVE TË NDËRTESAVE

- Kërkesa e zhvilluesit për kryerjen e oponencës; ku te cilësohet faza e projektit
- Detyra e projektimit e miratuar nga zhvilluesi për objektet që financohen nga buxheti i shtetit (origjinale ose fotokopje e kopjes së njësuar me origjinalin);
- Studimi gjeologo-inxhinierik i sheshit të ndërtimit (fotokopje e kopjes së njësuar me origjinalin)
- Dokumentacioni topografik i objektit;
- Studimi inxhiniero – sizmiologjik (kopje e njësuar me origjinalin) për objekte mbi tetë kate dhe objektet arsimore dhe shëndetësore ose vërtetim nga Instituti i Gjeoshkencave për objekte nën tetë kate;
- Projekti arkitektonik i firmosur nga arkitekti, shoqëruar me relacionin arkitektonik + projekti ne DWG
- Projekti konstruktiv, i firmosur nga konstruktori, shoqëruar me relacionin teknik të hartuar dhe të firmosur nga konstruktori, deklarata noteriale e konstruktorit mbi hartimin e projektit konstruktiv, si dhe llogaritjet analitike në CD ( modeli llogaritës) ;
- Projekti hidrosanitar, i firmosur nga inxhinieri hidroteknik (kanalizime, ventilim, ngrohje, mbrojtje nga zjarri), si dhe relacioni përkatës;
- Projekti elektrik, i firmosur nga inxhinieri elektrik, si dhe relacioni përkatës;
- Projekti i ngrohje-ftohje-ventilim, i firmosur nga inxhinieri, së bashku me relacionin teknik shpjegues;
- Projekti i mbrojtjes nga zjarri, i firmosur nga inxhinieri, së bashku me relacionin teknik shpjegues;
- Projekti i plotë i sistemimeve të jashtme, i firmosur nga inxhinieri, së bashku me relacionin teknik shpjegues;
- Projekti i plotë i lidhjes së objektit me rrjetin inxhinierik kryesor, i firmosur nga inxhinieri, së bashku me relacionin teknik shpjegues;
- Përfshirja e elementeve të aksesueshmërisë në projektet e objekteve të reja dhe në rikonstrukcione për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara;
- Preventivi i plotë i projektit, duke përfshirë të gjitha volumet e punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit dhe i firmosur nga grupi preventivues i pajisur me licencën përkatëse;
- Specifikimet teknike të firmosura nga inxhinierët përkatës;
- Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- Nipti I shoqërisë (porositësit)
- Certifikata e përkohshme e performancës së energjisë;
- Dokumentacioni ligjor i nevojshëm përfshin :
  - licencat përkatëse të personit juridik apo fizik projektues/projektuesit;
  - dëshmitë e kualifikimet përkatëse;
  - policën e sigurimit;
  - deklaratën e përgjegjësisë profesionale të projektuesit;
  - kontratën e shërbimit midis zhvilluesit dhe investitorit.
- Materialet duhet të jenë në gjuhën shqipe
- Dokumentacioni i përcaktuar paraqitet në formë hard copy ose elektronike.